Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoj kërkesën Nr.01-553-52621 të datës 20.11.2019 të parashtruar nga Kolë Musollaj nga fsh. Gurrakoc, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës për shpenzimet e varrimit të bashkëshortës Roza Musollaj, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.01-553-52621 të datës 20.11.2019 të parashtruar nga Kolë Musollaj për ofrim të ndihmës financiare për shpenzimet e varrimit të bashkëshortes Roza Musollaj dhe i ndahen **150€(njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shpenzimet e varrimit.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Kolë Musollaj në pajtim me procedurat e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Kolë Musollaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-52621 të datës 20.11.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndihmohet duke i ndarë mjete për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron te arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e lendes shihet se Kolës i ka vdekur bashkëshortja, gjendjen ekonomike e ka të vështirë dhe perkrahet duke i ndihmuar me mjete financiare për shpenzimet e varrimit.

Në planin e programit buxhetor të Zyrës së Kryetarit është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Kolë Musollaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit njoftohen: Kolë Musollaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-42/020	Data: Datum: 18.02.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në Rregulloren për ndarjen e Subvencioneve Nr. 1/2014, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shqyrtoi kërkesën Nr.05-400-4857 të datës 05.02.2020 të parashtruar nga Klubi i karatesë "LIRIA" Istog, për mbështetjen materiale për pjesëmarrjen e garueses Diellza Sejdiaj në garat ndërkombëtare të EKF-Federata Europiane e Karatesë dhe WKF-Federata Botërore e Karatesë për vitin garues 2020 dhe i propozoi Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.05-400-4857 të datës 05.02.2020, e parashtruar nga Klubi i karatesë "LIRIA" Istog, për mbështetjen materiale për pjesëmarrjen e garueses Diellza Sejdiaj në garat ndërkombëtare të EKF- Federata Europiane e Karatesë dhe WKF- Federata Botërore e Karatesë për vitin garues 2020,dhe përkrahet në shumë prej 700€ (shtatëqind euro) duke i paguar shpenzimet e akomodimit gjegjësisht ushqimit, dhe shpenzimet për paisje personale sportive.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Klubit të karatesë "LIRIA", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Klubi i karatesë "LIRIA" Istog, ka parashtruar kërkesën Nr.05-400-4857 të datës 05.02.2020, për përkrahje financiare për pagesën e shpenzimeve, për pjesëmarrjen e garueses Diellza Sejdiaj në garat ndërkombëtare të EKF- Federata Europiane e Karatesë dhe WKF- Federata Botërore e Karatesë për vitin garues 2020 ndërsa shpenzimet tjera i kryen organizatori.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Garuesja e Klubit të Karatesë "LIRIA" Diellza Sejdiaj është kualifikuar për pjesëmarrje në përfaqësuesen e Kosovës në konkurrencen kumite (luftëra) në kategoritë U21 dhe në Seniore në garat individuale dhe ekipore, për shkak të rëndësisë së pjesëmarrjes së garueses Diellza Sejdiaj në këto gara ndërkombëtare për të përfaqësuar vendin tonë Kosovën në mesin e 52 shteteve tjera, përkrahet nga komuna me pagesën e shpenzimeve të akomodimit gjegjësisht ushqimit, dhe shpenzimet për paisje personale sportive, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Kulturë,Rini dhe Sport është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e e Klubit të karatesë "LIRIA" në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit do të njoftohen: Klubi i Karatesë "LIRIA", Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-43/020	Data: Datum: 18.02.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 12 par 12.3 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenin 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Komisioni i Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc, shqyrtoi kërkesën Nr.06-016-1614 të datës 13.01.2020, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Klinës, për lejin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Izet (Rrusta)Vishaj nga fshati Doberdol, Komuna e Klinës dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-016-1614 të datës 13.01.2020, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Klinës, për lejin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Izet (Rrusta)Vishaj me nacionalitet shqiptar, me shtetësi kosovar i lindur me 11.12.1954, në fshatin Doberdol, Komuna e Klinës.
2. Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin për një periudhë të pacaktuar.
3. Shtëpia e Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj Izet (Rrusta)Vishaj gjatë qëndrimit në këtë institucion.
4. Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së që të përcjell dhe të mbikqyrë gjendjen e të strehuarit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.
5. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Komisioni i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shqyrtoj, kërkesën Nr.06-016-1614 të datës 13.01.2020, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Klinës, për strehimin e të moshuarëve, shqyrtoi dosjen e Izet (Rrusta)Vishaj i cili tani me adresë të vendbanimit në Klinë, i vetëm dhe pa përkujdesje familjare kushtet e jetesës i ka të vështira, nuk ka as një anëtar të familjes, më herët është trajtuar edhe me ndihmë sociale nga QPS-Klinë, nuk ka qenë i martuar dhe nuk ka fëmijë, nuk posedon pasuri të paluajtshme, të vetmin burim për ekzistencë e ka pensionin e luftës si veteran i UÇK-së.

Komisioni në përbërje të plotë ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar nga Qendra për Punë Sociale në Klinë dhe ka konstatuar nga të dhënat dhe raportet mjekësore se te i lartëcekuri Izet (Rrusta)Vishaj nuk vërehet ndonjë sëmundje ngjitëse apo psikike, është i sjellshëm, vërehet se ka nevojë për kujdes dhe pastërti për arsye se kushtet ku jeton janë jo të mira.

Komisioni për rastin në fjalë ka vendos ti lejoj strehimin në një periudhë të pacaktuar, dhe ka konstatuar se duhet t'i lejohej strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Izet (Rrusta)Vishaj Ilir Bacaj-Drejtor i QPS-së në Klinë, Haki Ibrahimaj-Drejtor i QPS-së Istog, Menaxheri i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-49/020	Data: Datum: 21.02.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionit përzgjedhës, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** propozimi i Komisionit përzgjedhës për vendin e punës: Zyrtar për Gjendje Civile 1, në Drejtorinë për Administratë Komunale.
2. Për Vendin e punës: Zyrtar për Gjendje Civile 1, pranohet kandidatja **Antigona Kaliqani**.
3. E lartëpërmendura punës ja fillon pasi të kaloj afati i ankesave.
4. Obligohet Personeli që të zbatoj këtë vendim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Antigona Kaliqani, Personeli, Drejtoria për Administratë Komunale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


 Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.52/020	Data: 26.02.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim 05.Nr.49/2020 të datës 03.02.2020, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Skender Aliaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Biologjisë, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.49/2020 e datës 03.02.2020, e parashtruar nga Drejtoria për Arsim për kompenzim të 3(tri) pagave në shumën që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit- pensionimit të Skender Aliaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Biologjisë, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 31.03.2020.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Skender Aliaj t'ia bëjë pagesën, e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Skender Aliaj, Drejtoria për Arsim, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompenzime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ



	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	01 Nr.53/020	Data: 26.02.2020	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim 05.Nr.67/2020 të datës 18.02.2020, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Sahit Balaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjeografisë, në SHFMU "Avni Rustemi" në Zallq, Komuna e Istogut dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.67/2020 e datës 18.02.2020, e parashtruar nga Drejtoria për Arsim për kompenzim të 3(tri) pagave në shumën që i ka marr tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Sahit Balaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjeografisë në SHFMU "Avni Rustemi" në Zallq, Komuna e Istogut.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 20.03.2020.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Sahit Balaj t'ia bëjë pagesën, e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Sahit Balaj, Drejtoria për Arsim, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompenzime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	01 Nr.54/020	Data: 26.02.2020	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë për Arsim 05.Nr.75/2020 të datës 19.02.2020, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Feta Fetahaj, me titull të postit: Mësimdhënëse e ciklit fillor (1-5) në SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh, Komuna e Istogut dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.75/2020 e datës 19.02.2020, e parashtruar nga Drejtoria për Arsim për kompenzimin të 3(tri) pagave në shumën që i ka marr tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Feta Fetahaj, me titull të postit: Mësimdhënëse e ciklit fillor (1-5) në SHFMU "Ndre Mjeda" në Rakosh, Komuna e Istogut.
2. Mësimdhënëses së lartpërmendur i përfundon shërbimi me 02.03.2020.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Feta Fetahaj t'ia bëjë pagesën, e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Feta Fetahaj, Drejtoria për Arsim, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompenzime dhe një kopje mbetet në arkivën e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-55/019	Data: Datum: 26.02.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin 02Nr.14/020 të datës 14.02.2020, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin: 02 Nr.14/020 të datës 14.02.2020 për pozitën: **Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa**, në Drejtorinë për Arsim, me numër të referencës RN00005995, 1 (një) ekzekutues dhe komision caktohen:
 1. **Sami Metaj**, Zyrtar i Lartë Ligjor, Kryesues i Komisionit;
 2. **Emina Coković**, Zyrtare për Buxhet dhe Financa 2, anëtare;
 3. **Brahim Hetemaj**, Udhëheqës i Sektorit të Shendetësisë, anëtar;
 4. **Florije Bytyçi**, Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Ulët, anëtare dhe
 5. **Valentina Alihajdaraj**, Zyrtare për Çështje Pedagogjike, anëtare.
2. Komisioni i lartëcekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën: **Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa**, me numër të referencës RN00005995, 1 (një) ekzekutues, në pajtim me procedurat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftoj Menaxherin e Personelit për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohet: Komisioni, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-56/020	Data: Datum: 27.02.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit, për formim të komisionit për pranimin e punëve për projektin: "Furnizimi i klubeve me rekuizita" me numer të brendshëm prokurimi 633-019-104-121 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për pranimin e punëve për projektin: "Furnizimi i klubeve me rekuizita" me numer të brendshëm prokurimi 633-019-104-121, të cilën e ka realizuar operatori "SPORTING" NT dhe në komision caktohen:

1. **Faruk Shala**, Tajner i K.H."Istogu", Kryesues i Komisionit;
2. **Fatmir Hakaj**, Sekretar i klubit K.F "Istogu", anëtar dhe
3. **Frasher Bujupaj**, Trajner i K.A "Olimpik", anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, operatori "SPORTING" NT dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ**


**Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA**


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr.57/020	Data Datum: 27.02.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) për formimin e Grupit Punues për “Mbështetjen e komunave për aplikim në Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë si dhe Agjencinë Kosovare për Eficiencë të Energjisë”, nxjerr:

VENDIM

1. FORMOHET: Grupi Punues për mbështetjen e komunës për Aplikim në Fondin e Kosovës për Eficiencë, i cili do të bëjë selektimin e dy projekteve (një objekt publik komunal dhe një rrugë me ndriqim publik)dhe në komision caktohen:

1. **Isa Hoxhaj**, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, Kryesues i Grupit Punues;
2. **Naim Sadriaj**, Zyrtar për Standarde,Vlerësim dhe Monitorim, anëtar;
3. **Rexhep Blakaj**, Arkitekt-Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm, anëtar;
4. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar dhe
5. **Fisnik Shoshi**, Zyrtar Ligjor 2 ,anëtar;

2. Grupi punues ka për obligim të bëjë selektimin e dy projekteve (një objekt publik komunal dhe një rrugë me ndriqim publik); të bëjë inçizimin e gjendjes për hartimin e projektit ingjinerik dhe auditimin energjetik; të hartoj projektet për selektimin e projekteve me qëllim që objekti respektivisht rruga me ndriqim publik të ketë potencial të lartë të kursimit të energjisë elektrike dhe të jetë pjesë e PKVEE; do t’i kryejë edhe punët dhe përgjegjësitë që janë në natyrën e këtij Grupi Punues.

3. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, që t’i ofrojë mbështetje Grupit Punues të lartëcekur.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi Punues dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij vendimi njoftohen: Grupi punues, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-58/020	Data: Datum: 28.02.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionit përzgjedhës, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** propozimi i Komisionit përzgjedhës për vendin e punës: Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Për Vendin e punës: Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1, pranohet **Drinor Blakaj** me pikë të fituara **84.4%**.
3. I lartëpërmenduri punës ja fillon pasi të kaloj afati i ankesave.
4. Obligohet Personeli që të zbatoj këtë vendim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: **Drinor Blakaj**, Personeli, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


